

TË DREJTAT TONA NË PUNË (në rast sëmundje/aksidenti/shtatzënie)

Ekzistojnë dallime të mëdha prej rastit në rast. Atëherë, parashtrohet pyetja se çfarë të drejtash kemi në rastet e tilla? Çka thotë ligji? A n'varet kjo nga lloji dhe përmbajtja e kontratës që posedojmë, nga kohëzgjatja e marrëdhënieve të punës, apo edhe nga lloji i sigurimit të punëdhënësit tonë (ose edhe nga sigurimi ynë)?

Është gabim të mendohet se rregullat për këtë pyetje janë gjithkundë njëlojë. E gjithë kjo do të n'varet kryesisht nga këto faktorë:

- **Përmbajtja e kontratës së punës që posedojmë**
- **Kohëzgjatja e marrëdhënieve të punës**
- **Lloji i sigurimit që është lidhur në kuadër të punës**

Obligimi për me e informuar punëdhënësin

Kjo është një detyrim i rëndësishëm në rastet e sëmundjes/aksidentit. Në parim, **çertifikata mjekësore kërkohet vetëm pas ditës së tretë** të pushimit mjekësor. Mirëpo, ekzistojnë kontrata që parashikojnë tepër e më tepër prezantimin e një çertifikate që nga dita e parë e pushimit mjekësor. Kjo me siguri lidhet me dyshimet e keqëpërdorimeve që i hasim ndonjëherë.

Pagesa dhe ndikimi i kohëzgjatjes së punës

Nëse kohëzgjatja e punës nuk i ka tejkalar një vitë, pagesa e rrogës së plotë në rast të sëmundjes/aksidentit mbulonë minimum tre javë. Pas vitit të parë, e gjithë do të n'varet pastaj nga ajo se sa vite jemi në marrëdhënie pune, nga lloji i kontratës që e kemi lidhur dhe nga forma e sigurimit që e ka zgjedhur punëdhënësi ynë (apo edhe ne vetë).

Janë të shumtë ata punëdhënës që lidhin sigurime të cilat mundësojnë që punëtorit t'i bëhet **pagesë diku 80%** nga rroga e tij, edhe ate brenda afateve të gjata, mirëpo kjo nuk mund të tejkalojë **720 ditë**.

A mund të shkëputet kontrata brenda kohës së sëmundjes/aksidentit ?

Punëdhënësi nuk ka të drejtë që t'a shkëpusë kontratën tuaj të punës për arsye sëmundje, edhe ate

- gjatë 30 ditëve të para (të sëmundjes), nëse marrëdhënia e punës nuk tejkalonë një vitë
- gjatë 90 ditëve, nëse marrëdhënia e punës përfshinë një periudhë kohore prej një deri pesë vite
- gjatë 180 ditëve, nëse marrëdhënia e punës ka arritur mbi gjashtë vite. Rregullë kjo që vlenë edhe për rastet e shtatzënisë, për periudhën 16 javore pas lindjes

Për personat që ushtrojnë aktivitet të pavarur

Mbulesa për rastet e tilla ekziston **vetëm për personat që kanë lidhur ndonjë sigurim** që parashikon mbrojtjen për këtë. Ekzistojnë sigurime që bëjnë pagesa **brenda 730 ditëve e më tepër**.

Renta invalidore

Nëse pagesa për raste sëmundje ka marrë fundë e ndërkohë ende ekziston paaftësia për punë, atëherë mund të bëhet një kërkesë në kuadër të sigurimit invalidor.

Përpiluar nga

Zyra për këshilla juridike – Begzati
Av. J. J. Rousseau 7, 2000 Neuchâtel